



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezimi Punësi/Pradani Received/Delivery		30.03.2022		2	viti qend year
Organ / Institucioni Org / Inst	Rr / Prad Rr / Prad No	Shtesa Pjesë Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKPM SHCK	1701/2022		0/4		

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr. 142/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 142/2022, të datës 18.02.2022, së ankuesit të parashtruar nga Shoqëria e Avokateve me adresë banimi nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridik “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 30.03.2022, mori këtë;

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A. Nr. 142/2022 e datës 18.02.2022, e parashtruar nga ankuesit
- II. MBETET në fuqi vendimi i datës 14.03.2022 me numër protokoll 805, Z. V, Sekretarit të Ministrisë së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD) me datë 18.02.2022, e cila ankesë është regjistruar në KPMSHCK me numër protokoll 845/2022 ankuesi ka parashtruar ankesë përmes Shoqërisë së Avokateve “SCLR Partners”, me pretendimet ankimore kundër vendimit të datës 20.01.2022, me numër protokoll 168, të Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 21.02.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa me datë 25.02.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr.142/2022 e datës 18.02.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 845/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 20.01.2022, i Z.V Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Dekret i datës 30.12.2021; Dekret i datës 29.12.2021, i Presidentes së Republikës së Kosovës; Akt Emërimi i datës 21.05.2012, i ankuesit Akt Emërimi i datës 21.05.2013;Formauri për vlerësimin e punës provuese; Vendimi i datës 20.04.2012, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi me numër A.Nr. 02/121/2012, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 17.06.2012, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimi i datës 30.04.2014, i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendim i datës 04.03.2014; Vendimi i datës 01.01.2017, i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Propozim i datës 29.04.2014, për lëvizje paralele; Dekret i datës 11.10.2019, i Presidentit të Republikës së Kosovës; e- maili i datës 10.02.2022; Kërkesë e datës 21.01.2022; Vendimi A. Nr. 963/2021, i datës 19.01.2012, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 25.02.2022, me numër protokoll 993/2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të shkresave lidhur me ankesën e ankuesit konstaton se Presidentja e Republikës së Kosovës me datë 29.12.2021, ka nxjerr dekret, me të cilin ka urdhëruar tërheqjen e ankuesit nga pozita „Shefit të misionit Ambasador i Republikës e Kosovës në Norvegji, duke e obliguar Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për ti ndërmarr veprimet për zbatim të Dekretit, ndërsa Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 20.01.2022, ka nxjerr Vendimin me numër protokoll 168, me të cilën ka zbatuar Dekretin e Presidentes së Republikës së Kosovës duke tërheq nga pozita Shef i Misionit/Ambasador i Republikës së Kosovës në Oslo të Norvegjisë dhe duke kthyer ankuesin në MPJD.

Zv.Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së me datë 14.03.2022 me nr.80/2022 ka nxjerr Vendim për sistemimin e përkohshëm të ankuesit në pozitën “Drejtor i Departamentit për Azi dhe Oqeani” MPJD.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimin ankimore të ankuesit i cili pretendon së ankuesi pas kthimit nga misioni i Republikës së Kosovës në Oslo/Norvegji , duhet që të sistemohet në pozitën „ Zëvendës Drejtorit i Përgjithshëm” në





Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, sipas akt emërimit të datës 21.05.2013. Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat relevante ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesi nuk janë të bazuara, sepse në bazë të Rregullores Nr. 01/2022, për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk është e paraparë pozita "Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm" në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ashtu siç ka pretenduar ankuesi në ankesë.

Ndërlidhur me pretendimet e ankuesit i cili pretendon që të sistemohet në pozitën „Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm” në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, sipas akt emërimit të datës 21.05.2013, kolegji konstaton se kjo pozita nuk është paraparë në bazë të nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Rregullores (ZKM) nr. 01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ku përcaktohet se; **1. Struktura organizative e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është si vijon: 1.2. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm; 1.3. Departamentet, dhe 1.4. Divizionet.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me qëllim të zbatimit të vendimit të datës 20.01.2022, me numër protokolli 168, Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 14.03.2022, me numër protokolli 805, ka nxjerr Vendim me të cilin ankuesin e ka sistemuar në mënyrë të përkohshme në pozitën „Drejtor i Departamentit për Azil dhe Oqeani”, pas kthimit nga misioni diplomatike i Republikës së Kosovës në Oslo/Norvegji.

Kolegji ka trajtuar edhe sistemin e përkohshëm të ankuesit në pozitën “Drejtor i Departamentit për Azi dhe Oqeani” në MPJD, por sipas imellit të datës 29.03.2022 MPJD ka sqaruar se për shkak të hyrjes në fuqi të Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MPJD, në kuadër të MPJD është themeluar Komisioni për Ristrukturim sipas Vendimit të datës: 24.02.2022 me nr.304, i cili Komision do të bëjë sistemin e përhershëm të nëpunësve civil ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka marrë për bazë edhe nenin 4, paragrafin 1, 2, nën paragrafi 2.5 të Ligji nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; **1. Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë. 2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve,** ndërsa mbi bazën e kësaj Kolegji konstaton se Ligji nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, i ka dhënë të drejtën që transferim dhe sistematizim ta rregullojë me Rregullore të Brendshme të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA NR. A. NR. 142/2022**

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Përfaqësuesit Shoqërisë së Avokateve " SCLR Partners
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

